REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
POLIÇAN

Nr.1030 Prot

Poliçan më 07 .08.2026

**Lënda: Njoftim për mbledhje lidhur me draft-propozimet e Reformës së Re Administrativo-Territoriale**

**Të nderuar Qytetarë!**
**Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Poliçan!**

**Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Poliçan**

Në zbatim të nenit 53 për funksionimin e Këshillit Bashkiak, pika 3 gërma "b", të Ligjit **nr.139/2015** "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, si dhe në zbatim të "Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Bashkiak", ju njoftojmë se më **dt.12.08.2026**, **ditën e Mërkurë,** ora **11:00,** në ambjentin e sallës së Këshillit Bashkiak do të zhvillohet mbledhja jashtë radhe e Këshillit të Bashkisë Poliçan, për muajin Gusht **2026.**

**RENDI I DITËS:**

1. Për miratimin e fillimit të proçesit të konsultimit me komunitetin për raportin të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, si dhe pë projektligjin "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
2. Për miratimin e kalendarit të konsultimeve me komunitetin, grupet e interesit dhe përfaqsuesit e njësive administrative të Bashkisë Poliçan.
3. Ngarkimi i komisionit përkatës të Këshillit Bashkiak për administrimin e mendimeve dhe propozimeve të komunitetit, përgatitjen e raportit përmbledhës të konsultimit, hartimin e mendimit përfundimtar, paraqitjen e saj për miratim në një mbledhje të posaçme të Këshillit Bashkiak Poliçan.

Bashkëngjitur këtij njoftimi do të gjeni draft-hartën e propozuar dhe relacionin teknik shpjegues për ndryshimet administrative që prekin zonën tonë.

Pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve është e domosdoshme, duke pasur parasysh rëndësinë jetike që ky vendim ka për përfaqësimin e qytetarëve, buxhetimin dhe autonominë tonë vendore.

Ju lutemi të konfirmoni praninë tuaj!

Me respekt,

**KRYETARE E KËSHILLIT**
**Mimoza Lulaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI BASHKIAK POLIÇAN

**Tel: 0368 2 4200 ; Email: njvbashkiapolican@gmail.com**